

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAÇ/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 7531 Nr. i faq/Br.str/No.pg 56  
Data/Datum/Date 19 / 06 / 26  
RAHOVEC / ORAHOVAÇ



INFORMIM RRETH  
AKTIVITETEVE  
DHE PROJEKTEVE  
NË KOMUNËN E  
RAHOVECIT



Qershor 2026



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

HYRJE

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit,

Kemi kënaqësinë të paraqesim para jush një informatë për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën janar - qershor 2026, si dhe ecurinë e implementimit të projekteve kapitale në komunën e Rahovecit gjatë kësaj periudhe.

Sukseset tona të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, besojmë se sukcesi ynë më i madh i përbashkët ka qenë tejkalimi i sfidave e i barrierave në favor të qytetarit rahovecas. Me bashkëpunim të ndërsjellë, me mirëkuptim dhe punë të palodhura ne kemi arritur që në këtë periudhë që po e lëmë pas të realizojmë me sukses një sërë projektesh që janë jetike për të ardhmen e Komunës së Rahovecit. Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikatat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale.

Informata që po e paraqesim sot përfshin detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë.

### FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS

*Të nderuar bashkëqytetarë!*

*Tash kur është bërë një periudhë nga qeverisja jonë, qyteti që drejtojmë e me të cilin bashkë ndajmë fatin tonë çdo ditë, me patjetër mund të konstatojmë se ka marr një dimension të ri zhvillimi e shprese në çdo kënd të trupit të territorit të tij. Jo nga rastësia, as nga vetzhvillimi, por nga punët publike që janë në vlim përgjatë gjithë territorit të komunës së Rahovecit, e nga vullneti këmbëngulës i rahovecianëve për t'i dhënë ngjyrë zhvillimi çdo pjesë të territorit tonë. Kudo në lagje, rrugë publike, kënde rekreacioni, fshatra e kthina të qytetit e fshatit, po vendosim dorën në projekte që për dekada kanë vuajtur mungesën nga vet qytetarët. Ato natyrisht, nuk do të ishin të prekshme, konkrete e shërbyese të qytetarëve pa një vullnet të hekurt që ta bëjmë Rahovecin më të mirë në çdo kënd të tij. Suksesi padyshim nuk është vetëm një fjali që duan ta dëgjojnë të gjithë. Është një përpjekje shumëjavore, konstante e vullnetplotë për ta bërë ndryshimin në secilën fushë ku lypset kompetenca jonë vendimmarrëse. Edhe kjo përmbledhje në vijim është një storie suksesi. Është përmbledhja e djersës së qindra punonjësve të administratës komunale që shërbimet për qytetarin të kenë gjithmonë cilësinë e nevojshme e shpejtësinë maksimale. Kjo është pasqyra sesi unë bashkë me ekipin tim për secilën ditë të punës sonë gjatë vitit të parë të qeverisjes në këtë mandat, ndonëse edhe pa sfida nuk shpëtuam, arritëm t'ia dalim, në përmbushje të objektivave qeverisëse e vizionit për transformimin e Rahovecit të nisur qysh nga fillimi i qeverisjes sonë.*

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### ZOTIMET

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

### PRIORITETET PËR VITIN 2026:

#### Përfundimi i Sheshit Qendror të Qytetit;

- Përfundimi i Ballkonit Panoramik;
- Investime të tjera në kanalizimin e ujërave të zeza dhe në disa rrugë në pjesë problematike të qytetit;
- Plotësim-ndryshimi i rregulloreve të Komunës së Rahovecit;
- Plotësim-ndryshimi i Statutit të Komunës së Rahovecit, përfshirë edhe logon;
- Përfundimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion;
- Rritje e përkrahjes në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturore-artistike dhe klubeve sportive;
- Rritje e subvencionimit për projekte kulturore-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Promovimi i turizmit dhe forcimi i sektorit të bujqësisë në komunën e Rahovecit;
- Krijim i kushteve për operim të bizneseve lokale (infrastrukturë në përputhje me PZhK-në dhe HZK-në);
- Punë praktike me pagesë për të rinjtë;
- Zgjerim i bashkëpunimit me qendrat grumbulluese dhe përpunuese të perimeve dhe të rrushit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2026-2030;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, për tregtinë, për zejet e veçanta, për artizanalet etj.;
- Realizim i planit të të hyrave komunale;

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm;
- Bashkëpunim me OJQ-të, bizneset dhe grupet e interesit;
- Rrugë fushore të reja dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese;
- Përkrahje për fermerët me farëra dhe inpute bujqësore;
- Projekte dhe investime konkrete për digjitalizimin e bujqësisë;
  
- Shërbime veterinarë periodike falas;
- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore;
- Përkrahje financiare me bursa për studentët dhe nxënësit e dalluar të komunës;
- Bibliotekat - kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete - do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinete;
- Tabela digjitale në shkolla;
- Rritja e përkrahjes nga 500 euro sa ishte në vitin 2025 në 600 euro për çdo lindje në maternitetin e Rahovecit për vitin 2026;
- Sigurimi shëndetësor për fëmijët në çerdhe;
- Rritje e numrit dhe e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit sa më të mirë dhe profesional;
- Funkcionalizimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i hapësirave publike;
- Mirëmbajtja e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe të përrenjve;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KRU "Gjakova" dhe me donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne;

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### SYNIMET PËR VITIN 2026:

- Politika të favorshme për investitorët nga mërgata dhe investitorët në sektorin e energjisë së ripërtërishme.
- Përkrahje për bizneset lokale me hapësira të reja, inkubatorë biznesi dhe bashkëfinancim të ideve inovative, me fokus gratë dhe të rinjtë.
- Zhvillim ekonomik dhe punësim përmes fuqizimit të sektorit privat.
- Investime për zhvillimin e agroturizmit.
- Projekte me partneritet publiko-privat.
- Projekte dhe investime konkrete për digjitalizimin e bujqësisë;
- Mirëmbajtje dhe hapje e rrugëve fushore për fermerët.
- Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore.
- Subvencionim i fermerëve me farëra, plehra dhe makineri bujqësore.
- Përfundimi i ndërtimit të shkollave të reja.
- Arsimit cilësor përmes pajisjes së shkollave me laboratorë, teknologji informative dhe mjete bashkëkohore mësimore.
- Modernizimi dhe pasurimi i bibliotekave shkollore.
- Zgjerimi i listës së barnave esenciale.
- Pajisja e QMF-ve me aparate EHO.
  
- Mbështetje për punësimin e mjekëve të rinj.
- Modernizimi i shërbimeve stomatologjike dhe diagnostike.
- Investime në pajisje mjekësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
- Fushata ndërgjegjësuese për barazi gjinore dhe përfshirje sociale.
- Pastrimi i ujërave dhe i përrrenjve.
- Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.
- Eliminimi i deponive ilegale dhe krijimi i lokacioneve të përshtatshme për deponim.
- Vazhdimi i trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe përrrenjve.
- Investime për mbrojtje nga vërshimet.
- Rritja e të hyrave vetanake përmes lejeve ndërtimore dhe lejeve mjedisore.
- Legalizimi i objekteve pa leje në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse.
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirimit të pronave të uzurpuara.
- Mbështetje për procesin e legalizimit të objekteve pa leje.
- Përmirësimi i menaxhimit të pronës komunale.
- Zbatimi i legjislacionit për trajtimin e objekteve pa leje.
- Mbikëqyrja e respektimit të standardeve mjedisore dhe urbanistike.
- Kontrolli dhe parandalimi i deponive ilegale.
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast fatkeqësish natyrore dhe emergjencash të tjera.
- Ngritja e kapaciteteve lokale për reagim ndaj krizave dhe vërshimeve.

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



- Përmirësimi i efikasitetit administrativ dhe i shërbimeve për qytetarët.
- Mbështetje institucionale për zbatimin e planeve zhvillimore dhe koordinimin ndërdrejtorial.
- Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe digjitalizimit të shërbimeve komunale.
  - SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2026
  - MUNGESA E MJETEVE FINANCIARE SI PASOJË E OBLIGIMEVE QË
  - RRJEDHIN NGA PROCEDURAT PËRMBARIMORE DHE KONTRATAT
  - KOLEKTIVE NË SEKTORIN E ARSIMIT (4,541,987.40€)
- Realizimi i projekteve strategjike në përputhje me planifikimin buxhetor dhe objektivat zhvillimore të komunës.
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset konsultative dhe vendimmarrëse;
- Tërheqja e investimeve dhe mbështetjes nga donatorët dhe partnerët zhvillimorë;
- Menaxhimi efikas i pronës dhe aseteve komunale;
- Nxitja e zhvillimit ekonomik lokal dhe krijimi i mundësive për punësim;
- Inkasimi i të hyrave nga taksat komunale;
- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për realizimin e prioriteteve zhvillimore të komunës;
- Përballimi i sfidave që lidhen me ndryshimet klimatike dhe eficiencën e energjisë;

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### RRITET SHUMA E SUBVENCIONIMIT TË LINDJEVE.

Kryetari Latifi nënshkroi vendimet e para për subvencionimin e dy lindjeve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Nga janari i këtij viti, çdo lindje e realizuar në repartin e maternitetit të QKMF-së "Dr. Fahredin Hoti", do të mbështetet nga Komuna e Rahovecit me 600€, nga 500€ sa ishte më parë, ndërsa deri në fund të mandatit, në përputhje me zotimin e dhënë, subvencionimi do të rritet në 750€.



### Takim koordinues për vlerësimin e dëmeve nga reshjet dhe vërshimet në Rahovec

Kryetari Latifi priti në takim z. Kastriot Lajqi, kryesues i komisionit qeveritar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, së bashku me bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë takimit diskutuan për situatën e krijuar nga reshjet e fundit dhe vërshimet në komunën e Rahovecit, si dhe për veprimet e ndërmarra nga komuna, përfshirë aktivizimin e komisionit komunal dhe të ekipit mbështetës për regjistrimin dhe vlerësimin profesional të dëmeve në terren.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### **Ratkoci edhe këtë herë tregoi zemër të madhe!**

Për 22 vjet u organizua aksioni i dhurimit vullnetar të gjakut, ku shumë qytetarë iu përgjigjën thirrjes për të ndihmuar ata që kanë nevojë. Këtë vit, ky aksion tradicional iu kushtua Mehmet Hotit (Meta), homazh për njeriun që ishte gjithmonë i pari për të dhuruar gjak dhe nismëtar i kësaj vepre humane.

Dhurimi i gjakut shpëton jetë dhe anadrinasit e dëshmojnë këtë vlerë me vepra, jo me fjalë.

Përgëzoj organizatorët, banorët e Ratkocit dhe të Anadrinisë, si dhe stafin e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, për këtë aksion shumë të rëndësishëm, por edhe të suksesshëm!



### **Kryetari Latifi priti në takim përfaqësuesit e kompanive dhe auditorët mbikëqyrës të projektit të turbinave me erë në Zatriq.**

Gjatë takimit u diskutua për ecurinë e investimeve, përfitimet që projekti do t'i sjellë komunës së Rahovecit, si dhe rëndësinë e koordinimit ndërmjet Komunës, investitorëve dhe auditorëve për realizimin e projektit sipas standardeve të parapara.

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### DREJTORI I OSBE-SË U PRIT NGA KRYETARI LATIFI

Kryetari i Komunës Smajl Latifi priti në takim drejtorin e OSBE-së së Qendrës Rajonale në Prizren, z. Fitim Nuhii dhe bashkëpunëtorët e tij.

Diskutuan për partneritetin e ndërtuar deri më tani dhe rëndësinë e vazhdimit të tij, për mbështetjen konkrete nga OSBE-ja, veçanërisht përmes trajnimeve dhe fondeve që adresojnë nevojat dhe prioritetet e Komunës.



### U SHËNUA MANIFESTIMI PËRKUJTIMOR DHE LETRAR "FLAKA E JANARIT"

Në 36-vjetorin e përjetësimit, te vendi i rënies në lakun e Brestocit, nderuan kujtimin për heronjtë: Nesimi Elshani nga Nagaci, Agron Fetahu nga Celina, Halim Hoti nga Krusha e Madhe dhe Hilmi Krasniqi nga Hoça e Vogël  
Po ashtu në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj" u mbajt programi artistik nga Shoqëria "Bajram Curri" si dhe u bë shpallja e fituesve të konkursit letrar.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVCIT



### KOMUNA E RAHOVCIT DHE FORUMI "FARDI" NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Së bashku me Kryetarin e Forumit Anadrini (FARDI), profesorin Qerim Kadiri, kryetari i Komunës Smajl Latifi, nënshkruan një memorandum bashkëpunimi për iniciativa dhe për projekte konkrete.

Komuna e Rahovecit do të ofrojë mbështetje institucionale dhe logjistike, ndërsa përmes këtij partneriteti forcohet bashkëpunimi dhe zhvillimi në fushëveprimtari të ndryshme.



### U SHËNUA 18-VJETORI I PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në shënim të 18-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, kryetari i Komunës së Rahovecit priti në zyrën e tij qytetarë dhe përfaqësues të institucioneve.

Më pas u bënë homazhe dhe u nderua kujtimi i atyre që sakrifkuan jetën për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Aktivitetet për këtë ditë të veçantë vazhduan me krenari dhe përkushtim.



Kryetari Latifi priti në takim pronarët e barnatoreve private në Rahovec. Gjatë takimit u diskutua për organizimin e kujdestarisë, respektimin e orarit të punës dhe koordinimin mes barnatoreve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve farmaceutike të vazhdueshme për qytetarët.

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Kryetari i Komunës, Smajl Latifi, i shoqëruar nga Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Atdhe Rama, u prit sot nga Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, z. Agim Ademi.

z. Agim Ademi e uruan për rizgjedhjen e tij dhe diskutuan për standardizimin e fushave të futbollit sipas kriterëve të UEFA-s, ku Kryetari Latifi mori mbështetje të plotë për këto projekte që do të përmirësojnë infrastrukturën sportive.



## U PËRKUJTUA EPOPEJA E UÇK-SË

Në shënim të 28-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, përfaqësues të Komunës së Rahovecit, së bashku me veteranë, invalidë të luftës dhe qytetarë, bënë homazhe në nderim të sakrificës së familjes së Adem Jasharit dhe të gjithë dëshmorëve që ranë për lirinë e Kosovës.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### KOMANDANTI I RC-W TË KFOR-IT, KOLONEL FEDERICO MORA VIZITOI KOMUNËN E RAHOVECIT

Kryetari i Komunës mirëpriti Komandantin e RC-W të KFOR-it, Kolonel Federico Mora.

Gjatë takimit u diskutua për sigurinë, forcimin e bashkëpunimit dhe përkrahjen në projekte për qytetarët, si dhe u shpreh mirënjohje për kontributin e KFOR-it në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë.



### VIZITË ZYRTARE DHE SHKËMBIM PËRVOJASH NDËRMJET RAHOVECIT, MIRDITËS DHE MALLAKASTRËS

Me kënaqësi u mirëpritën nga Kryetari i Komunës dhe nga Kuvendi asambleistët nga Këshilli Bashkiak i Mirditës dhe Mallakastrës në kuadër të një vizite studimore 2-ditore në Komunën e Rahovecit.

### Përkrahje për kultivuesit e trangullit “kornishan” dhe specit

Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me Qendrën Grumbulluese “Agro Celina” Sh.P.K., gjatë vitit 2026 do të mbështesë fermerët me fidanë dhe inpute bujqësore për kultivimin e trangullit dhe specit.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi për praktikantë me pagesë në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit dhe Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren kanë formalizuar një marrëveshje bashkëpunimi, përmes së cilës do të angazhohen tre praktikantë me pagesë në administratën komunale.



### Në hartën historike të Rahovecit i shtohet edhe Polluzha

Në kuadër të manifestimeve “Epopeja e UÇK-së”, në Polluzhë u bë zbulimi i një pllake përkujtimore që shënon vendet historike dhe kontributin e kësaj zone në rrugën e lirisë. Me këtë rast u nderua figura e Sali Bajraktarit dhe u theksua rëndësia e Polluzhës si pjesë e trashëgimisë historike dhe kombëtare të komunës së Rahovecit.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### LIGJËRATË INFORMUESE NË KUADËR TË DITËS BOTËRORE TË TUBERKULOZIT

Në kuadër të 24 Marsit, Ditës Botërore të Tuberkulozit, u mbajt një ligjëratë informuese me nxënësit e klasave 10, 11 dhe 12 të IAAP “Selajdin Mullabazi Mici”, në ambientet e QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.



Gjatë kësaj ligjërate, Dr. Elbunit Kryeziu ndau informacione mbi parandalimin, simptomat dhe trajtimin e tuberkulozit.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve mbeten thelbësorë në luftën kundër kësaj sëmundjeje.



### Kryetari Latifi në panelin e “Javës së Gruas” për qeverisje të ndjeshme gjinore

Me ftesë të NDI-së, Kryetari Latifi mori pjesë në panelin e organizuar në kuadër të “Javës së Gruas”, ku u diskutua për qeverisjen e ndjeshme gjinore dhe rëndësinë e kthimit të dialogut në veprime konkrete. Gjatë diskutimit u theksua përvoja e Komunës së Rahovecit në avancimin e barazisë gjinore dhe përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse.





## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### Kryetari Latifi mori pjesë në mbledhjen e Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon



Kryetari Latifi, i shoqëruar nga drejtori, Altin Zhuniqi, mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe Asamblesë së Përgjithshme të Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon, ku u diskutua për projektet e përbashkëta dhe programet e financimit për periudhën 2026–2027.

### Ambasadorja e Finlandës në Kosovë

Kryetari Latifi priti në takim Ambasadoren e Finlandës në Kosovë, znj. Eevamari Laaksonen. Gjatë takimit u diskutua për forcimin e bashkëpunimit në fushat e bujqësisë, arsimit, turizmit dhe mundësitë e binjakëzimit të Rahovecit me një komunë në Finlandë.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### NËNSHKRUHEN KONTRATAT PËR SUBVENCIONET NË KULTURË, RINI DHE SPORT

Kryetari i Komunës, Smajl Latifi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. At dhe Rama, nënshkruan kontratat me përfituesit e subvencioneve në këto fusha:

- \* Kulturë - 13 OJQ, në vlerë prej 79,100 €;
- \* Rini - 4 OJQ, në vlerë prej 21,700 €;
- \* Sport - 17 klube dhe organizata sportive, si dhe shkolla të futbollit, në vlerë prej 142,200 €.



### Mirënjohje për Zjarrfikësit në Ditën Ndërkombëtare të tyre!



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Zjarrfikësve, Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Irfan Berisha, vizitoi Njësinë e Zjarrfikësve në Rahovec dhe ndau mirënjohje për punën dhe përkushtimin e tyre në shërbim të qytetarëve dhe situatave emergjente.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### TRAJNIM PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE DHE FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL

Është mbajt trajnimi në tavolinë (TTX) për forcimin e kapaciteteve të institucioneve komunale në menaxhimin e emergjencave.

Ky trajnim u realizua në bashkëpunim me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe ekipin amerikan për çështje civile. Në ushtrim morën pjesë drejtoritë komunale dhe akterë të tjerë të rëndësishëm, përfshirë Policinë e Kosovës, Shërbimin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, QKMF Rahovec, Kryqin e Kuq – dega Rahovec, KEDS – dega Rahovec, si dhe KRU Gjakova – dega Rahovec.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte identifikimi i kapaciteteve ekzistuese dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional për reagim sa më efikas në situata emergjente.

### TAKIMI I MEKANIZMIT KOMUNAL KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Kryetari Smajl Latifi mbajti takimin e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe akterëve relevantë, me qëllim të koordinimit të veprimeve dhe fuqizimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.




## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### 27 Prilli - Dita e të Zhdurve me Dhunë në Kosovë

Kryetari Latifi mori pjesë në ekspozitën me fotografi të organizuar nga Shoqata “Kreshniku” dhe në homazhet e mbajtura në Krushë të Madhe për personat e zhdur me dhunë gjatë luftës. Me këtë rast, u nderua kujtimi i të zhdurve dhe u ritheksua kërkesa për zbardhjen e fatit të tyre dhe vendosjen e drejtësisë.



### Shënimi i Ditës së Dëshmorëve të Kombit

Me rastin e 5 Majit – Ditës së Dëshmorëve të Kombit, Kryetari Latifi, së bashku me familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të OVL-UÇK-së, bashkëpunëtorë dhe qytetarë, nderoi kujtimin e të rënëve për liri. U theksua se sakrificat e dëshmorëve duhet të reflektohet në punën e përditshme për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të zhvilluar.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### U PËRMBYLL ME SUKSES EDICIONI JUBILAR I FESTIVALIT TË FOLKLORIT “ANADRINIA JEHON”

Mbarëvajtja dhe suksesi i edicionit të 25-të të festivalit “Anadrinia Jehon” dëshmuar për punën, përkushtimin dhe bashkëpunimin e këshillit organizues, banorëve të fshatit Dejnë, strukturave të pushtetit lokal, ekipit të QKMF “Dr. Fahredin Hoti”, Policisë së Kosovës, sigurimit fizik, njësisë së zjarrfikësve, medieve, publikut, si dhe të gjithë atyre që kontribuan në realizimin e këtij festivali.

Ky edicion konfirmoi se ky aktivitet kulturor me karakter kombëtar tashmë është konsoliduar dhe ka ndërtuar themele të forta në promovimin e kulturës dhe folklorit shqiptar. Pjesëmarrja e 17 grupeve artistike nga vise të ndryshme shqiptare ishte dëshmi e vlerës dhe jehonës që ka marrë ky festival ndër vite.



### Nis cikli i dëgjimeve publike për KAB 2026–2028

Është mbajtur dëgjimi i parë publik për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028, nën organizimin e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Në takim morën pjesë të rinj, gra, pensionistë dhe përfaqësues të komuniteteve pakicë. Grupi punues prezantoi dokumentin e ndarjeve buxhetore, i cili u shpërnda për të pranishmit.

Drejtori i financave paraqiti mundësitë buxhetore për vitin 2026, ndërsa pyetjet dhe kërkesat e qytetarëve morën përgjigje konkrete dhe do të trajtohen me kujdes.

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### Përkujtim për Ukshin Hotin në 27-vjetorin e zhdukjes së tij

Në 27-vjetorin e zhdukjes së Ukshin Hotit, u nderua jeta dhe vepra e tij si intelektual dhe veprimtar i çështjes kombëtare. U ritheksua kërkesa për zbardhjen e fatit të tij, duke mbetur e hapur pyetja për vendndodhjen e tij edhe pas 27 vite.



### “Korr e ha n’katun”



Në kuadër të aktivitetit “Korr e ha n’katun”, Kryetari Latifi vizitoi fermën bujqësore të Muharrem Hotit dhe Imer Durakut në Krushë të Madhe. Gjatë vizitës u vlerësua puna dhe përkushtimi i fermerëve vendorë, si dhe u ritheksua mbështetja e Komunës për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Në Ditën e Qendrës Kulturore “Mensur Zyberaj”, u përkujtua me nderim jeta dhe vepra e Heroit të Kosovës Mensur Zyberaj dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë e atdheut.



### Rahoveci shënoi 1 Qershorin – Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve

Me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, në çerdhen “Tulipanët” në Rahovec u organizua aktivitet festiv për fëmijët. U theksua rëndësia e gëzimit, kujdesit dhe mbështetjes për fëmijët si e ardhmja e shoqërisë.



Kryetari Latifi priti në takim përfaqësuesit e OJQ-së “EC Ma Ndryshe”, me të cilët diskutoi për zbatimin e projektit “Inventarizimi i shërbimeve administrative komunale” në Komunën e Rahovecit. Projekti synon standardizimin e shërbimeve dhe lehtësimin e procedurave për qytetarët, me qëllim rritjen e efikasitetit të administratës komunale.



## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### Vazhdon mbështetja për fermerët me inpute bujqësore

Ka filluar shpërndarja e plehut artificial për përfituesit e fazës së dytë të programit komunal për mbështetjen e fermerëve në Rahovec. Në këtë fazë përfitojnë 700 fermerë, me gjithsej 5.600 thasë pleh, me qëllim uljen e kostove të prodhimit dhe rritjen e rendimenteve bujqësore.



### Filluan punimet për ndërtimin e terrenit sportiv në Zatriq

Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë dhe në praninë e qytetarëve, mësimitdhënësve dhe nxënësve, mori pjesë në fillimin e punimeve për ndërtimin e terrenit sportiv në hapësirat e ShFMU “Dëshmorët e Zatriqit”. Projekti synon krijimin e kushteve moderne për zhvillimin e sportit dhe aktivitetit fizik për të rinjtë e Zatriqit.




## INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



### Fjala e Kryetarit Latifi në vigjilje të 27-vjetorit të çlirimit të Rahovecit

Në amfiteatrin e Kompleksit Përkujtimor të Dëshmorëve të Kombit në Gradish, në vigjilje të 27-vjetorit të çlirimit të Rahovecit me rrethinë, Kryetari Latifi mbajti një fjalë rasti ku nderoi sakrificën e luftëtarëve të lirisë dhe theksoi rëndësinë e kujtesës historike dhe vlerës së lirisë së fituar me shumë sakrificë.



### Rahoveci shënon Ditën e Çlirimit – 14 Qershor

Në emër të Komunës së Rahovecit, u urua 14 Qershori – Dita e Çlirimit të Rahovecit. Me këtë rast u zhvilluan aktivitete përkujtimore, përfshirë pritjen tradicionale të qytetarëve dhe nxënësve si dhe homazhe në nderim të dëshmorëve të kombit.

